

 Republika e Kosovës Republika Kosova Republic of Kosova	DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS		 Komuna e Istogut Opstina Istok Municipality of Istog
	Nr. i lëndës: 11-351/56	Datë: 01.04.2026	

DËGJIM PUBLIK

Projekti për ndërtimin e një stacioni të ruajtjes së energjisë me bateri (BESS) pranë nënstacionit elektrik në Bellopojë

Njoftohet publiku i interesuar se më datë **14.04.2026** në ora **10:00** në sallën e Kuvendit Komunal në Istog, do të organizohet debati publik.

Debati publik do të organizohet në kuadër të finalizimit të Procesit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Aspektet Sociale (VNM), për këtë do të mbahet një takim informues me komunitetin lokal, me qëllim prezantimin e projektit dhe diskutimin e aspekteve mjedisore dhe sociale në mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse.

Ky përfaqëson një zhvillim strategjik për sektorin energjetik në Kosovë.

Ky investim, i cili financohet nga MCA Kosova, synon të rrisë sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike, të mbështesë integrimin e burimeve të rinovueshme dhe të përmirësojë balancimin e rrjetit energjetik. Në këtë kuadër, projekti kontribuon drejtpërdrejt në modernizimin e infrastrukturës energjetike dhe në avancimin e objektivave të Kosovës për një sistem energjetik më të qëndrueshëm dhe më efikas.

Qëllimi i takimit është informimi i komunitetit mbi projektin e propozuar, si dhe diskutimi i aspekteve mjedisore dhe sociale në kuadër të VNM paraprake, duke mundësuar një shkëmbim të hapur mendimesh dhe adresimin e çdo shqetësimi apo komenti nga palët e interesuara.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e këtij projekti të rëndësishëm.

Drejtorja për Planifikim Urban dhe Mjedis

Drejtori i DPUM
 Kushtrim Buleshka


